

Tiranë më, datë 17.10.2017

NJOFTIM

Për aplikantët e interesuar për të ndjekur praktikën profesionale 2018,

Ju njoftojmë se mbështetur në nenin 15 dhe 16 të Ligjit 10091 datë 5.03.2009 “Për auditimin Ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar), kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në praktikën profesionale për të marrë titullin Auditues Ligjor, duhet të depozitojnë pranë IEKA-s, në periudhën **1 deri 15 Nëntor 2017** dokumentat më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për pranimin në praktikën profesionale drejtuar Komitetit të Edukimit dhe Kualifikimit Profesional;
2. CV e aktualizuar;
3. Kartë Identiteti (kopje);
4. Diplomë e shkollës së lartë (e noterizuar), ku përfshin:
 - a) Diplomë Bachelor (3-vjecare) dhe diplomë “Master” ose;
 - b) Diplomë e integruar e nivelit të dytë ose ;
 - c) *Diplomat e barasvlershme me to, në përputhje me kategorizimet që bëhen në ligjin Nr.10307, datë 22.7.2010 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, për çdonjërin nga degët e studimit në shkencat ekonomike, si kontabilitet, financë, administrim biznesi, ekonomiks apo të barasvlershme me to)*
5. Lista e notave (e noterizuar) për cdo diplomë;
6. Dëshmi penaliteti;
7. Marrëveshje e praktikës profesionale me kontratë me kohë të plotë tre vjeçare;
8. Deklaratën noteriale që tregon se kandidati nuk ka asnjë marrëdhënie punësimi me punëdhënësin të tjerë, duke filluar nga që nga **01 Janar 2018**;
9. Kontratë individuale pune me drejtuesin e praktikës profesionale (bazuar në Kodin e Punës në RSH);
10. Mandatin e pagesës për tarifën e aplikimit 4000 lek;

Numrat e llogarive bankare të IEKA-s :

Emertimi i llogarisë: Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
Pershkrimi: tarifë aplikimi në praktikën profesionale

Intesa SanPaolo Bank
Nr Llog: 1008131801 IBAN: AL11208110080000001008131801

Banka Kombetare Tregtare
Nr Llog: 402034661 IBAN: AL30 2051 1021 0346 61CL OTCL ALLA

Raiffeisen Bank
Nr Llog: 100003298 IBAN: AL89202110130000000100003298